

Traditat tona

Nga skena e teatrit partizan në skenën e teatrit profesionist

(Në 25-vjetorin e teatrit «A.Z. Çajupi» të Korçës)

Andon Mara,

Thina Filipi

Në rrethin e Korçës, ashtu si në të gjithë vendin, Partia qysh në muajt e parë të vitit 1942, udhëzoi dhe mori masa për organizimin e lëvizjes artistike antifashiste, puna konkrete e së cilës iu ngarkua organizatës së rinisë komuniste. Në qytet u ngrit një bërthamë kulturore artistike, e cila kishte për detyrë të përgatiste dhe të zhvillonte veprimtarinë kulturore e artistike, duke aktivizuar veçanërisht të rinj dhe të reja me aftësi në këtë fushë. Veprimtaria e kësaj bërthame filloi me shkruarjen e vjershave, të teksteve për këngë, skicave e skeqeve, të cilat përfshiheshin në repertorin e shfaqjeve.

Shfaqjet artistike u shtuan e u përhapën gjithnjë edhe më shumë në lagjet e qytetit. Masiviteti u bë një tjetër tipar dallues i tyre. Gjatë viteve 1943 e 1944 shfaqjet u bënë pjesë të domosdoshme të jetës së përditshme luftarake të rinisë dhe të popullit. Ato jepeshin gati çdo javë në mbledhje të ndryshme, të përgatitura nën drejtimin e aktiveve të rinisë komuniste në lagje, të cilat filluan të vepronin me inisiativë, për t'iu përgjigjur kërkesave të rinisë.

Me dhjetëra ishin të rinjtë e të rejtë komunistë e antifashistë të qytetit, të cilët u aktivizuan në grupet e ndryshme teatrale gjatë viteve 1942-1944, që interpretuan role në skeqet dhe pjesët më të gjata teatrale, punëtorë, nxënës, mësues, vajza shtëpiake etj. Bërthama kulturore-artistike nuk e zhvillonte veprimtarinë e saj vetëm brenda në qytet, por e shtrinte atë dhe në shumë fshatra si në Drenovë, Boboshticë, Ravonik, Dishnicë, Çiflik, Polenë, Pojan, Rembec e gjetkë.

Të gjithë autorët e pjesëve që shfaqeshin dhe ata që i vinin në skenë e i luanin ishin pjesëmarrës të Luftës Nacionalçlirimtare. Sot në një aksion, nesër në një tjetër. Sot një luftim, nesër një tjetër. Ky aktivizim i fuqishëm në luftë i ushqente ata me temat dhe subjektet aktuale. Pjesëmarrja e gjallë në këtë jetë plot probleme nevralgjike, ngjarje dhe veprimtari që kërkonte shpirt heroik, sakrificë dhe përsëri devotshmëri me besim në fitore i mbante ata në kontakt të vazhdueshme me atë jetë, aty në vijën e parë të luftës, ku shpërthente heroizmi partizan, ku ishin heronjtë e gjallë, që futeshin pastaj pjesë të tyre dramatike e përmes tyre në skenën e teatrit partizan. Kështu qysh në lindjen e tij teatri ynë i revolucionit fitonte ato tipare që hyjnë në traditën më të mirë të teatrit tonë të realizmit socialist. Ai buronte nga jeta, nga lufta, ishte i lidhur me të dhe i shërbente Luftës Nacional-

çlirimtare. Aty i merrte subjektet, aty kapte dhe problematikën që pasqyronte. Bile edhe aktorët në mes të kësaj lufte, ku bënin pjesë, gjenin shpesh ato që ne sot i quajmë «prototipa realë», për të dhënë pastaj sipas mundësisë të talentit figurat artistike të personazheve e karaktereve që interpretonin. Në vazhden e kësaj tradite teatri ynë i pasqyrimi i forcon lidhjet me jetën në ndërtimin socialist të vendit, në mes klasës punëtore, fshatarësisë kooperativiste e kudo në gji të popullit që punon dhe mbron Atdheun socialist. Ishte pikërisht kjo lidhje e fuqishme me jetën, që i siguronte teatrit partizan atë vërtetësi të madhe jetësore si në trajtimin e pjesëve, të skeqeve të ndryshme, ashtu edhe në mënyrën se si viheshin në skenë e interpretoheshin ato, pavarësisht se shokët dhe shoqet që e bënin këtë teatër nuk kishin as shkollën e kulturën e nevojshme profesionale. Me vërtetësinë e jetës e të luftës ata njëkohësisht kompensonin deri në një farë mase disa të meta në lojën e aktorit e në kompo-

ndër në Rembec u ngrit një grup teatral kryesor, nën drejtimin e organizatës së Partisë të kësaj zone. Me ritjen dhe zgjerimin e lëvizjes amatore teatrale në ato vite dolën dhe i zhvilluar më tej edhe shumë talente. Kështu ish aktori partizan Dh. Trajçe caktohet regjisor i grupit teatral të Rembecit. Po kështu me detyrën e regjisorit caktohet më vonë dhe aktori partizan Pandi Raidhi.

Viti 1944 vit vendimtar i Luftës Nacionalçlirimtare që mori përplotësim të gjithanshme, të cilat u dhane grushte vdekjeprurëse pushtuesve fashistë dhe veglave të tyre napi edhe horizonte më të mëdha të dencësmit dhe të organizimit të lëvizjes teatrale partizane. Përpara, krahas shtrirjes gjerësisht të kësaj lëvizjeje në çdo qytet, fshat dhe njësi të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, u kujdes dhe vepra për organizimin e grupeve qendrore të një niveli më të ngritur. U nodhën kështu bazat e institucioneve të ardhshme artistike kryesore që do të kishin të afërmi Shoqëria e lirë. Kështu, p.sh., në Lavdar të Oparit, në ish qarkun e Korçës, me elementë nga radhët partizane dhe me shokë e shokë, që u dërguan nga qyteti i Korçës u krijua grupi artistik i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, embrioni i Ansambllit Artistik të Ushtrisë sonë Popullore.

Lufta e madhe çlirimtare, në të cilën u hodhë populli ynë me në krye Partinë, kushtet politike dhe ekonomiko - shoqërore solën ndryshime cilësore edhe në qëllimet, brendinë dhe në formën e lëvizjes së re teatrale, tiparet realiziste të së cilës filluan të formohen në Luftën Nacionalçlirimtare. Skeqet dhe pjesët e tjera teatrale patën si tema kryesore ato të luftës për liri e pavarësi, kundër pushtuesve fashistë e tradhtarëve, shfaqjet e shumta të heroizmit dhe të vendosmërisë së popullit, të komunistëve e të rinisë në luftë, të traditave atdhetare të popullit si edhe të luftës ndërkombëtare antifashiste.

Krahas pjesëve dramatike u shkruan dhe u vunë në skenë skeqe e pjesë të tjera, që demaskonin ose satirizonin tradhtarët e Ballit Kombëtar, të Legalitetit, spiunët e xhandarët, kuizlingët e


veprat e tjera të fashistëve e të nazistëve. Satira dhe humori zunë një vend të gjerë në shfaqjet teatrale së bashku me numra të tjerë në programet, ato përbënë zanafillën e teatrit tonë të estradës. Janë pikërisht këto tiparet të militantizmit, të realizmit e të masivitetit që zhvillon e pasuron më tej lëvizja jonë teatrale profesioniste dhe amatore.

Gjatë viteve 1942-1944 në qytet dhe në zona të lira u shkruan dhe u vunë në skenë skeqe e pjesë të tjera, brendinë, titujt dhe autorët e të cilave ne i njohim ende, pjesërisht, siç janë: «Hakmarrja», «Vëllavrasja», «I arratisuri», skeqi mbi pjesëmarrjen e rinisë në luftë (shkruar nga Aleko Skali), «I torturuari» (shkruar nga Stefanaj Pollo dhe Dhimitër Trajçe), «Konferenca e intelektualëve», «Katërbëdhjet vjeç dhëndër» e A. Z. Çajupit, «Kryengritja në Çiflik», inskenime nga «Epopeja e Ballit Kombëtar» e Shevqet Musarajt, «Luftëtari i Lirisë», «Zogu në mërgim» e shumë e shumë skeqe e pjesë të tjera skenike.

Në këto pjesë të thjeshta, me anën e të cilave dramaturgjia jonë e re hidhte hapat e saj të parë, shqueshin brendia e fuqishme ideopolitike, mendimet e qarta, një pathos revolucionar, që bënte për vete spektatorët, një gjuhë dinamike e individualizuar dhe kumtuese, një atmosferë e gjallë e ngjarjeve të kohës. Karakteristikë e përgjithshme e pjesëve të ndryshme është se në qendër të tyre zinte vend heroi pozitiv që ishte partizani, komunisti, punëtori, fshatari, i riu dhe e reja, që luftonin në zonat e pushtuara, masa e popullit. Antagonistët ishin fashistët e tradhtarët. Zgjidhja e problemeve të trajtuara ishte gjithmonë pozitive, në anën e popullit dhe të luftës së tij. Nuk mungonin, doemos, për fazën e parë të teatrit tonë, në ndonjë rast edhe notat melodramatike apo natyraliste.

Shfaqjet teatrale luajtën një rol të madh edukues dhe mobilizimi politik e luftarak në rini dhe në popull. Midis tyre edhe spektatorëve krijoheshin lidhje të menjëhershme ideomocionale. Spektatorët ndiqnin me shumë vëmendje shfaqjet dhe ndikoheshin thellë prej tyre.

Të shumta janë rastet që pas shfaqjeve, të rinj dhe të reja, fshatarë e njerëz të tjerë nga populli, ngriheshin e jepnin fjalën se do të shkonin partizanë dhe hidheshin në mal. Raste të tilla në mënyrë masive kanë ndodhur, p.sh., me shfaqjen «I torturuari» në Pojan më 9 shtator 1943, me shfaqjen në Dushar etj. Dhe kjo vinte kryesisht për shkak se ajo që pasqyrohej me vërtetësi artistike në skenë ishte marrë nga vetë jeta dhe lufta e popullit tonë, prekte «telat» e tija, frymëzonte dhe grishte kudo për luftë e fitore. Me këtë përvojë të fituar gjatë luftës partizane teatri ynë amator, ashtu si në të gjitha rrethet e tjera të vendit, erdhi e ngjiti më pas skenat e teatrit profesionist. Me tiparet e tija revolucionare e me atë tingëllim të paharruar militant teatri partizan mbetet gjithnjë objekt studiimi e frymëzimi për të gjithë shkrimtarët dhe artistët e skenës, sidomos për aktorët e punonjësit më të rinj të saj, që hyjnë papushim në radhët e teatrit tonë të realizmit socialist.



Një kujtim i kohës së Luftës Nacionalçlirimtare, shkruar nga Artisti i Popullit Pandi Raidhi.

mentë të tjerë, që vinin nga mungesa e përvojës, por njëkohësisht hidhnin një bazament aq të vlefshëm në themelet e teatrit tonë të realizmit socialist, karakteristikat e të cilit i ruajnë dhe i zhvillojnë sot lëvizja jonë teatrale profesioniste dhe amatore.

Në verën e vitit 1943, veprimtaria teatrale mori një formë më të përqëndruar në zonën e fushës edhe të rrëzës së Korçës. Me qe-